




Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railëay Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 2 dhe 65 të Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

Rregullore Nr. 01/2018 mbi Modalitetet për Llogaritjen e Kostos që është Shkaktuar Drejtpërdrejt si Rezultat i Operimit të Shërbimit të Trenit

1.1. Ndonjë drejtësi nuk ka drejtësi të rishtruar që tashmë ka një objektet (pa kushtet) që ka qenë së shpejtë.

1.2. Mësimdhënuesi i kushtet që ka qenë së shpejtë, nuk ka drejtësi të rishtruar që tashmë ka një paragjegj.

1.3. Vlera e kushtet që ka qenë së shpejtë, nuk ka drejtësi të rishtruar që tashmë ka një paragjegj.

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Eeb:eee.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të bëhet përcaktimi i modalitetave për llogaritjen e kostos direkte që është shkaktuar drejtpërdrejt si rezultat i operimit të shërbimit me trena.

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha llojet e kostos direkte të shkaktuara si rezultat i operimit të trenave brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 3 **Definicionet**

"Kostoja direkte" nënkuption koston e cila është shkaktuar drejtpërdrejt si rezultat i operimit të shërbimit me trena;

"Kostoja direkte njësi" nënkuption koston direkte për tren kilometër, kilometrat e mjetit lëvizës, bruto ton kilometrat e një treni ose një kombinim të tyre;

"Qendra e kostos" nënkuption një njësi afariste brenda sistemit të kontabilitetit të menaxherit të infrastrukturës, në të cilën janë të alokuara kostot për hir të shpërndarjes së këtyre kostove direkte ose indirekte në një shërbim të tregtueshëm.

Neni 4 **Kostot direkte në nivel të gjithë rrjetit**

4.1 Kostot direkte në nivel të gjithë rrjetit do të llogariten si diferençë në mes të kostove të ofrimit të shërbimeve të pakos minimale të qasjes dhe qasjes në infrastrukturën e cila i lidhë objektet (pajisjet) shërbyese, në njëren anë, si dhe kostot e papranueshme të përmendura në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, në anën tjeter.

4.2 Menaxheri i infrastrukturës mund të vendosë që t'i aplikoj shpenzimet e ofrimit të shërbimeve efikase për qëllime të llogaritjes së kostove direkte për të gjithë rrjetin të referuar në paragrin 1.

4.3 Vlerat e aseteve të përdorura për qëllim të llogaritjes së kostove direkte në nivel të gjithë rrjetit duhet të bazohen në vlerat historike, ose aty ku këto vlera nuk janë të disponueshme, apo ku vlerat aktuale janë më të ulëta sesa vlerat e zakonshme. Vlerat historike të aseteve duhet të bazohen në shumat e paguara dhe të dokumentuara nga menaxheri i infrastrukturës në kohën e blerjes së këtyre aseteve. Në rastin e shlyerjes së borxhit, ku i gjithë borxhi apo një pjesë e borxheve të menaxherit të infrastrukturës merret nga një entitet tjeter, menaxheri i infrastrukturës duhet të bënë zgjërimin e vlerave të aseteve dhe kostot përkatëse direkte në nivel të gjithë rrjetit për aq sa është vlera e borxhit të shlyer. Duke iu shmangur fjalisë së parë, menaxheri i infrastrukturës mund të përdorë vlera të cilat përfshinë vlerat e llogaritura,

vlerat aktuale ose vlerat e zëvendësuara nëse ato mund të maten në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe objektive dhe të arsyetohen siç duhet tek organi rregullator.

4.4 Nëse menaxheri i infrastrukturës mund të bëjë matjen dhe demonstrojë në mënyrë transparente, të fuqishme dhe objektive në bazë të, ndër të tjera, praktikës më të mirë ndërkomëtare që kostot janë të shkaktuara drejtpërdrejt nga operimi i shërbimit me trena, atëherë menaxheri i infrastrukturës në llogaritjen e kostove të veta direkte në nivel të gjithë rrjetit mund të përfshijë në veçanti kostot e mëposhtme:

4.4.1 shpenzimet e stafit të nevojshëm për mbajtjen e një pjese të caktuar të linjave të hapura, nëse një aplikant kërkon të ketë një shërbim të caktuar me trena të planifikuar jashtë kohës së rregullt të punës të kësaj linje;

4.4.2 një pjesë të shpenzimeve të infrastrukturës së skambjeve (ndërrueseve), duke përfshirë këtu skambjet dhe kryqëzimet të cilat janë të ekspozuara ndaj konsumimit si pasojë e shërbimit me trena;

4.4.3 një pjesë të shpenzimeve të ripërtëritjes dhe mirëmbajtjes të rrjetit kontaktues, shinës së tretë të elektrifikuar ose të dyjave, dhe pajisjeve mbështetëse të rrjetit kontaktues të shkaktuara drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit me trena; si dhe

4.4.4 shpenzimet e personelit të nevojshëm për përgatitjen e alokimit të traseve të trenave dhe orarit të trenave deri në masën që ato janë të shkaktuara drejtpërdrejt si rezultat i operimit të shërbimit me trena.

4.5 Kostoja e përdorur për llogaritjen sipas këtij neni do të bazohet në pagesat e kryera ose të parashikuara nga menaxheri i infrastrukturës. Kostot e llogaritura sipas këtij neni do të maten ose parashikohen në mënyrë të qëndrueshme në bazë të dhënavë nga e njëjta periudhë kohore.

Neni 5 **Kostot e papranueshme**

5.1 Menaxheri i infrastrukturës nuk duhet të përfshijë në llogaritjen e kostove direkte në nivel të gjithë rrjetit në veçanti kostot e mëposhtme:

- 5.1.1 kostot fikse të cilat duhet t'i mbartë menaxheri i infrastrukturës për linjat hekurudhore në mungesë të lëvizjeve të trenave;
- 5.1.2 kostot që nuk kanë të bëjnë me pagesat e bëra nga menaxheri i infrastrukturës. Kostot apo qendrat e kostos të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me sigurimin e pakos minimale të qasjes ose për të hyrë në infrastrukturën e cila i lidh objektet (pajisjet) shërbysese;
- 5.1.3 kostot për blerjen, shitjen, çmontimin, dekontaminimin, rikultivimin ose dhënen me qira të tokës ose aseteve të tjera fikse;
- 5.1.4 kostot operative në nivel të rrjetit, duke përfshirë pagat dhe pensionet e tërësishme;
- 5.1.5 kostot e financimit;
- 5.1.6 kostot që lidhen me progresin teknologjik ose vjetërsimin;
- 5.1.7 kostot e aktiveve jo-materiale;
- 5.1.8 kostot e senzorëve të binarëve, pajisjeve të komunikimit të binarëve dhe pajisjeve të sinjalizimit nëse nuk janë të shkaktuara drejtpërdrejtë nga funksionimi i shërbimit me trena;
- 5.1.9 kostot e informimit, pajisjet e komunikimit ose pajisje telekomunikuese të cilat nuk shtrihen përgjatë binarëve;

- 5.1.10 kostot që lidhen me incidentet individuale të forcës madhore, aksidenteve dhe ndërprerjeve të shërbimeve duke mos paragjykuar nenin 35 të Direktivës 2012/34 / BE;
- 5.1.11 kostot e pajisjeve të furnizimit me energji elektrike për tërheqjen e trenave nëse nuk janë të shkaktuara drejtpërdrejtë nga operimi i shërbimit me trena. Kostot direkte të operimit të shërbimeve me trena të cilët nuk i përdorin pajisjet elektrike të furnizimit, nuk duhet t'i përfshijnë kostot e përdorimit të pajisjeve të furnizimit me energji elektrike;
- 5.1.12 kostot që lidhen me sigurimin e informacionit të përmendur në pikën 1 (f) të Shtojcës II të Direktivës 2012/34 / BE, përvèç nëse këto kosto dalin nga operimi i shërbimit me trena;
- 5.1.13 kostot administrative të shkaktuara nga skemat e pagesave të diferencuara, të referuara në nenet 31 (5) dhe 32 (4) të Direktivës 2012/34 / BE;
- 5.1.14 amortizimi i cili nuk është përcaktuar në bazë të konsumit real të infrastrukturës për shkak të operimit të shërbimit me trena; si dhe
- 5.1.15 një pjesë të kostove të mirëmbajtjes dhe rinovimit të infrastrukturës ndërtimore që nuk është drejtpërdrejtë e shkaktuar nga funksionimi i shërbimit me trena.

5.2 Nëse menaxheri i infrastrukturës ka marrë fonde për të financuar investimet specifike të infrastrukturës të cilat nuk është i detyruar t'i kthejë dhe kur këto investime merren parasysh në llogaritjen e kostove direkte, atëherë kostot e këtyre investimeve nuk duhet të rrisin nivelin e tarifave.

Neni 6 **Llogaritja dhe modulimi i kostove direkte për njësi**

6.1 Menaxheri i infrastrukturës llogaritë kostot mesatare direkte për njësi për të gjithë rrjetin duke i ndarë kostot direkte në nivel të gjithë rrjetit me numrin total të kilometrave të mjeteve lëvizëse, tren kilometrave ose bruto ton kilometrave të parashikuara ose të realizuara në të vërtetë.

6.2 Në vend të kësaj, nëse menaxheri i infrastrukturës i demonstron organit rregulator, se vlerat ose parametrat e përmendur në paragrafin 6.4 ndryshojnë dukshëm për pjesë të ndryshme të rrjetit të tij dhe pasi të bënë ndarjen e rrjetit të tij në pjesë të tilla, menaxheri i infrastrukturës do të llogarisë kostot mesatare direkte për njësi për pjesët e rrjetit të tij duke ndarë kostot direkte për këto pjesë të rrjetit me numrin total të kilometrave të mjeteve lëvizëse, tren kilometrave ose bruto ton kilometrave të parashikuara ose të realizuara në të vërtetë.

6.3 Për llogaritjen e kostove mesatare direkte për njësi, menaxheri i infrastrukturës mund të përdorë një kombinim të kilometrave të mjeteve lëvizëse, tren kilometrave ose bruto ton kilometrave, me kusht që kjo metodë e llogaritjes të mos shkaktoj ndryshimin e lidhjes së drejtpërdrejtë me operimin e shërbimit me trena. Duke mos paragjykuar Nenin 4, Paragrafin 4.3 të kësaj rregulloreje, menaxheri i infrastrukturës mund t'i përdorë kostot e parashikuara ose të realizuara.

6.4 Menaxheri infrastrukturës mund t'i modifikojë kostot mesatare direkte për njësi duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të konsumit të shkaktuar në infrastrukturë sipas një ose më shumë parametrave të mëposhtëm:

- 6.4.1 gjatësinë e trenit dhe / ose numrin e mjeteve lëvizëse në tren;
- 6.4.2 masën e trenave;
- 6.4.3 llojin e mjetit lëvizës, në veçanti masën e tij pa karoseri;
- 6.4.4 shpejtësinë e trenit;
- 6.4.5 fuqinë e mjetit tërheqës;
- 6.4.6 ngarkesën boshtore dhe / ose numrin e boshteve;
- 6.4.7 numrin e regjistruar të pjesëve jo të sheshta të rrotave ose përdorimin efektiv të pajisjeve përmbrrojtjen kundër rrëshqitjes së rrotave;
- 6.4.8 ngurtësia gjatësore e mjetit lëvizës dhe forcat horizontale që ndikojnë në binar;
- 6.4.9 energjia elektrike e konsumuar dhe e matur apo dinamika e pantografit ose pjesëve të kontaktit si një parametër përmbrrojtjen kundër rrëshqitjes së rrotave;
- 6.4.10 parametrat e binarëve, në veçanti rrezet e kthesave; si dhe
- 6.4.11 çdo parametër tjetër që lidhet me koston, kur menaxheri i infrastrukturës mund t'i dëshmojë organit rregullator se vlerat për secilin parametër të tillë, duke përfshirë ndryshimin e secilit parametër të tillë aty ku është e përshtatshme, maten dhe regjistrohen objektivisht.

6.5 Modulimi i kostove direkte për njësi nuk duhet të rezultojë në rritjen e kostove direkte në nivel të gjithë rrjetit, siç është referuar në Nenin 4, Paragrafin 4.1.

6.6 Kostot shtesë të shkaktuara për shkak të devijimit të kahjes së lëvizjes së trenave nga ana e menaxherit të infrastrukturës, të planifikuar ose të papritur, nuk përfshihen në kostot direkte të bëra nga operimi i këtyre shërbimeve me trena. Fjalia e parë nuk do të zbatohet nëse ndërmarrja hekurudhore rimburësohet nga menaxheri i infrastrukturës për këto shpenzime shtesë.

Neni 7 Modelimi i kostos

Menaxherët e infrastrukturës mund të llogarisin kostot direkte për njësi me anë të modelimit ekonometrik ose inxhinierik të kostove duke ia dëshmuar organit rregullator që kostot direkte për njësi përfshijnë vetëm kostot direkte të bëra nga operimi i shërbimit me trena, dhe në veçanti nuk përfshinë asnjerën nga kostot e përmendura në Nenin 5.

Neni 8 Kontrolli i thjeshtësuar

8.1 Nëse kostot direkte në nivel të gjithë rrjetit sipas Nenit 4, Paragrafit 4.1, ose kostot direkte të llogaritura në bazë të modelimit të përmendur në nenin 7 të shumëzuara me numrin e tren kilometrave, kilometrave të mjeteve lëvizëse dhe / ose bruto tonë kilometrave, të realizuara në periudhën referuese janë ekuivalente ose më të vogla se 15% të kostove të plota të mirëmbajtjes dhe rinovimit ose më pak se shuma prej 10% të kostove të mirëmbajtjes dhe 20% të kostos së rinovimit, atëherë organi rregullator mund të kryejë kontrollin e referuar në nenin 56 (2) të Direktivës 2012/34 / BE mbi llogaritjen e kostove direkte në nivel të gjerë të rrjetit në mënyrë të thjeshtësuar. Organi rregullator mund të vendos të rris përqindjet e përmendura në këtë paragraf, por jo më shumë se dyfishi i vlerave të treguara.

8.2 Organi rregullator mund të pranojë llogaritjen e kostos direkte mesatare për njësi të referuar në Nenin 6, paragrafin 6.1 dhe kostos direkte mesatare për njësi të referuar në Nenin 6, paragrafin 6.2 dhe / ose modelimin e kostos të përmendur në nenin 7, subjekt i kontrollit të thjeshtësuar dhe të referuar në paragrafin 8.1 të këtij neni, nëse kostot mesatare direkte janë të bazuara në këtë rregullore dhe legjislacionin tjeter përkatës.

8.3 Kontrollet e thjeshtësuara siç referohen në paragrafët 8.1 dhe 8.2 zbatohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Organi rregullator përcakton detajet e kontrollit të thjeshtësuar.

Neni 9
Shqyrtimi i llogaritjes

Menaxheri i infrastrukturës përditëson rregullisht mënyrën e llogaritjes së kostove direkte, duke marrë parasysh, ndër të tjera, praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

